



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 926/2 Prot.

Tiranë, më 25/7 /2017

REKOMANDIM

Nr. 34 datë 25/7 /2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.161, datë 15.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit Strehëza për Gra dhe Vajza Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.161, datë 15.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, është subjekt juridik me NIPT: K81505451M dhe aktivitet shërbimin e përkujdesit rezidencial për gra dhe vajza të dhunuara. Ky kontrollues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave "punëmarrës" e "përfituese".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, nuk ka kryer detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit.
Konstatimi i pikës 1 këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

"1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë".

2. Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, ka rregullore formale për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas standardit gjithpërfshirës publikuar në faqen zyrtare të Komisionerit, si e tillë, e pa përshtatur në funksion të veprimtarisë së kontrolluesit. Konstatimi i pikës 2 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

"1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera".

3. Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, në formularët tip të pranimit, "Të dhëna mbi rastin" mbledh të dhëna sensitive "Besimi fetar", e dhënë e cila në kuptim të nenit 5 gërma "c" e tejkalon qëllimin e përpunimit. Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 5 gërma "c" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

"1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim:".

4. Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, në arkivën e tij, ka të grumbulluara dosje të cilat datojnë që në fillimet e veprimtarisë së tij, viti 1992. Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 5 gërma "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar:

"1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:

d) në mbajtjen në atë formë, që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej".

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, të realizojë detyrimin për njoftim dhe në vazhdimësi detyrimin mbi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, të përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për "*Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale*".
3. Në zbatim të nenit 5, germa "c" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, të rishikojë gamën e të dhënave që mbledh, duke patur parasysh, mjaftueshmërinë e tyre, si dhe mos tejkalimin e qëllimit për të cilat janë mbledhur dhe përpunohen këto të dhëna.
4. Në zbatim të nenit 5, germa "d" të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, të parashikojë në rregulloren për "*Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale*", afatet ligjore të ruajtjes së të dhënave personale (dosjet) e përfitueseve.
5. Kontrolluesi Strehëza për Gra dhe Vajza - Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 3, dhe 4 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 60 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
6. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 22/1/2017

BESNIK DERVISHI

KOMISIONERI